



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 144/25, 06.11/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 24 tetor 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Adnan Lahu, Agron Perçuku, Fakete Dushi, dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Sylejman Mehulli dhe Nurie Halili.

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë: Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, drejtorët e drejtorive, Abit Abiti – zyrtar kryesor financiar.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Projekt – buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2026 – 2028.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – tha se Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Kryetarin e komunës e ka përgatitur një propozim-buxhet, i cili është në pajtim me Qarkoren Buxhetore, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe objektivat e komunës për vitin 2026, si dhe parashikimet për vitin 2027 – 2028. Materialin e keni marrë dhe nuk ju kisha lodhur me shifra. Po i ceku disa ndryshime që janë bërë dhe të cilat i keni para vetes, që kanë hyrë si projekte të reja dhe kërkoj që këto propozime të futen në projekt – buxhet:

- ***Ndërtimi i parkut të “Dynekut” – projekt i ri.***
- ***Ndërtimi i urës në Lumadh.***
- ***Ndërtimi i shkollës fillore “Emin Duraku” në Novolan.***
- ***Ndërtimi i shkollës fillore “7 Marsi” në Bukosh.***
- ***Ndërtimi i çerdheve të reja.***

Ai kërkoi që Drejtoria për Buxhet dhe Financa, gjatë futjes së të dhënave në sistem, të ketë një diskrecion, sepse ka raste kur disa projekte nuk janë në përputhje me një rregullore të definimit të projekteve kapitale. Ne nuk i ndryshojmë projektet, por duhet që të specifikohen projektet. Psh. E kemi një emërtim “ndërtimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse”, ndodhë që duhet të ndahen në shumë projekte, pasi që këtu e kemi vetëm një projekt.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se e kemi pasur një krizë buxhetore për shkak të Kontratës Kolektive, ku përmbaruesi na i ka marrë afër 11 milion euro. Afër 2 milion euro janë marrë nga lirimi i qytetarëve nga tatimi në pronë. I kemi diku rreth 13 milion euro që kemi pasur deficit buxhetor gjatë këtij mandati dhe kjo ka reflektuar te shumë projekte – investime kapitale që kanë qenë të planifikuara gjatë këtij mandati dhe nuk kemi mundur t’i realizojmë. Siç i përmendi disa edhe Abiti: Parku i “Dynekut”, projekti i tregut, sepse nuk kemi mundur t’i përcjellim operatorët me pagesa. Tani jemi në një pikë të planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitin 2027, 2028. Jemi munduar që ky buxhet të jetë gjithëpërfshirës, që i plotëson deri diku nevojat e qytetarëve, sepse më vonë mund të kemi nevojë prapë për buxhet. Shpresojmë që me bashkëpunimin që kemi pasur me institucionet qendrore, ministritë e linjës, prapë do ta vazhdojmë bashkëpunimin me Qeverinë e Republikës së Kosovës në realizimin e projekteve tjera me bashkëfinancim, veçanërisht të infrastrukturës shkollore dhe të çerdheve.

Ju falënderoj për bashkëpunimin katërvjeçar (pasi kjo mbledhje e KPF-së është e fundit në këtë mandat), për kontributin që keni dhënë në interes të qytetarëve. Kërkoj që ta procedoni për kuvend këtë projekt-buxhet, në mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit që e kemi thirr nga ora 15:00.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se nuk do të merr pjesë në votim, për arsye se kjo seancë është dashur të thirret në muajin shtator dhe është kaluar çdo afat ligjor. Derisa Ministria e Financave ju ka detyruar, nuk keni ndërmarrë asgjë. Ajo çka është shqetësuese për mua është se shumë herë i keni ndërruar projektet dhe tabelat në këtë draft-buxhet. Edhe sot na erdh një draft tjetër me ndryshime. Nuk është dashur me ju premtu qytetarëve në fushatë, e tash me i fut projektet në draft-buxhet. Është dashur të planifikohen më herët këto projekte, e jo para balotazhit. Çerdhet që i përmende kryetar, ministria ju ka kërkuar vetëm parcelat, kurse ju nuk i keni ndarë ato parcela. Për mua është e papranueshme dhe e patolerueshme të luhet me qytetarët, sepse shumica e projekteve janë të parealizueshme. Prandaj, për këto arsye unë nuk do të marrë pjesë në votim.

Adnan Lahu, anëtar i KPF-së – fillimisht ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pasur këto katër vite, pasi që kjo është mbledhja jonë e fundit. E kemi thënë shpeshherë që buxheti nuk është mirë të bllokohet nga asnjë subjekt politik, qysh është bllokuar para katër viteve. Për disa vite rresht, LDK-ja e ka përkrahur buxhetin, për shkak se buxheti nuk është i një subjekti politik, por i qytetarëve. Sot nuk kemi një mendim të qartë, sepse na erdhi një material shtesë tani për tani. Ne këtë çështje do ta vendosim në kuvend, por në këtë mbledhje do të abstenojmë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – lidhur me ndarjen e parcelave për çerdhe, ne e kemi dërguar kërkesën në ministri për ndërtimin e çerdhes në Smrekonicë dhe se nuk na është kthyer asnjë përgjigje në atë kërkesë. Kurse, për qytet nuk kemi pasur parcela për ndërtim të çerdheve. Për shumë projekte ka pasur skepticizëm nga disa që kanë thënë se nuk do të

realizohen. Edhe për parkingun nëntokësor ka pasur skeptik, por u realizua. Nëse e kemi buxhetin e plotë për dy vitet e ardhshme edhe së paku 11 milion euro, besoj fuqishëm që do të realizohen projektet. Nëse nuk i fusim në kodet buxhetore, më vonë do të kemi probleme, tha Idrizi.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota "për", asnjë "kundër" dhe dy (2) "abstenime", rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim projekt – buxheti, me propozimet shtesë që u dhanë nga zyrtari kryesor financiar .

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – dua ta shfrytëzoj rastin të ju falënderoj secilin që keni dhënë kontribut gjatë këtyre katër viteve në KPF dhe kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën **10:30**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës



Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e KK-së dhe KPF-së